

Dhuna në familje një fenomen negativ i dukshëm i shoqërisë së sotme dhe familjes moderne

Nga Sokol Kondakçiu

Nga frytet e zhvillimit dhe emancipimit të sotëm modern Shqipëria po përballet me një fenomen shumë negativ në shoqëri, krimi dhe dhuna, krimi në familje dhe jashtë saj. Është bërë gati normale të dëgjojmë çdo ditë në edicionet e lajmeve kronikën e zezë, e cila është bërë pjesë e rëndësishme e këtyre edicioneve, si dhe debateve të shumta nëpër studiot televizive. Është folur shumë për dhunën në familje, dhunën kundër fëmijëve dhe grave, vrasjeve dhe vetëvrasjeve të shumta, të cilat tanimë janë bërë normale për ne. Vetë kronika e zezë tashmë duhet vënë në pikëpyetje, sepse po ndihet pesha e saj në ndërgjegjen tonë sociale. Madje për këtë duhet hapur një debat më vete, a duhet t'i jepet kaq rëndësi asaj sa i jepet apo jo? Televizioni dhe rrjetet sociale po rezultojnë si mjete të efektshme për edukimin masiv të popullsisë, prandaj duhet shikuar me shumë vëmendje edhe ky fenomen ndikues.

Fakti që në shoqërinë tonë ndodh dhe është shtuar së tepërmi një fenomen i tillë është tregues, se shoqëria shqiptare lëngon dhe vuan nga shumë drejtime, të cilat nganjëherë njerëzit më të dobët i çon drejt dhunës në përgjithësi, drejt vrasjes apo edhe vetëvrasjes.

Nëse do të shikojmë më në thelb do të vërejmë se motivet e dhunës janë xhelozia, tradhtia, vjedhja, imoraliteti, stresi, varfëria e tejskajshme etj. Në studiot televizive diskutohet gjerë e gjatë rreth këtyre fenomeneve me pasion nganjëherë flitet edhe me keqardhje, por e gjithë vëmendja përqendrohet tek politika dhe forca politike në pushtet, se nuk ka bërë sa duhet për të ndaluar këtë fenomen.



Shpesh herë i vihet faji edhe policisë së shtetit, që në fakt nuk janë edhe pa faj. Mirëpo ne si shoqëri kemi nevojë për një pakt social, dhe modelet e duhura ku duhet të mbështetemi.

Modelet të cilat po na serviren për të zgjidhur këtë problem janë ligjet e Perëndimit, ku garantohen të drejtat dhe të sigurojnë jetën. Në fakt nuk janë simptomat e sëmundjes ato që duhet të na bëjnë neve përcaktimin e diagnozës, por shkaqet që i shkaktojnë këto simptoma, pra duhet ta thellojmë analizën tonë, se pse ndodhin këto fenomene në shoqërinë tonë, e cila më parë, edhe pse jo në këtë stad zhvillimi arsimor e teknologjik, nuk i ka pasur këto fenomene, e jo më me këto shifra të frikshme të krimit brenda familjes, apo edhe dhunës ndaj femrës.

Ndërkaq ne nga Perëndimi kemi huazuar vetëm modelet e hidhura dhe jo ato të punës me korrektësi, e për një jetë të qetë familjare.

Ne si popull në origjine kemi një kulturë lindore islame dhe si të tillë në vitet para-komuniste, dhe si pasojë edukata fetare ka qenë ajo mbizotëruesja në masen e popullit çka e bënte më të lehtë jetën me rregullat fetare, të cilat kishin në thelb të drejtën, dhe mbrojtjen e njeriut, mbase jo me garantuesin shtet, por nëpërmjet zakoneve dhe parimeve fetare dominuese.

Është e vërtete se nuk ka pasur krime të shumta, e as dhunë brenda familjes sa sot, ku ne mendojmë se jemi më mirë se sa para 60 vjetësh. Në fakt është Feja Islame ajo e cila garanton me forcën e parimeve të saj dhe ligjeve të saj mbrojtjen dhe sigurimin e jetës, pasurisë, dhe

nderit të njerëzve, sepse këto janë prej pesë qëllimeve të shenjta për të cilat ka ardhur Feja Islame.

Largimi nga besimi dhe parimet e tij hyjnore bën që njeriu ta humbë rrugën e drejtë, atë rrugë të ndriçuar nga Krijuesi i Tij thotë Allahu në Kuran: "Atë që Allahu e udhëzon në Islam ai vërtet është i udhëzuar, dhe kush largohet për të nuk do të gjejë udhëzues".

Në një vend të panjohur dhe mbushur plot rreziqe çdokush nga ne ka nevojë për udhëzues, që të gjejë rrugën e duhur, e cila nuk ka rreziqe dhe vështirësi.

Kjo botë në të cilën jetojmë i ngjan pak a shumë shembullit të lartpërmendur, nëse nuk do të kemi besim tek Allahu i Madheruar dhe në Kuranin Famëllartë ligjet e të cilit rregullojnë dhe garantojnë një jetë më të qetë dhe të lumtur në këtë botë, si dhe shpëtim në atë tjetrën.

Për të gjitha fenomenet dhe shkaqet që na çojnë deri në këtë pikë ka folur dhe i ka trajtuar Allahu i Madheruar në Kuran, dhe nëse nuk do t'i bindemi Atij, dhe nuk do t'i zbatojmë këto parime, atëherë nuk do të jemi të mbrojtur dhe të garantuar, sepse kemi marrë një rrugë, e cila nuk e dimë se ku do të na shpjerë në fund. Fundi është stres, sëmundje, dhunë, vrasje, vetëvrasje, grabitje, përdhunime etj., etj. Për sa thamë Allahu i Madheruar thotë: "E kush largohet nga përkujtimi ai do të jetojë një jetë të vështirë e në Diten e Gjykimit do ta ringjallim të verbër, do të thotë: Zoti im përse më ringjalle të verbër, kur unë kam qenë me shikim?... I thotë: Ashtu siç ti i harrove argumentet tona, po ashtu sot ne do të harrojmë ty".

E lusim Allahun e Madheruar për udhëzim në Islam për të gjithë për të gjetur shpëtimin dhe lumturinë e humbur.

Fq 4 / Disa faktorë që ndikuan në depërtimin e Islamit në trojet shqiptare

Nga Emërim Koçi

Fq 5 / Rruga drejt vendtakimit të dy deteve

Nga Neki Kaloshi

Fq 6 / Pastrimi i parave dhe qëndrimi i Islamit ndaj saj

Fq 7 / Familja qeliza bazë e shoqërisë

Nga Xhemal Balla

LHSH MBLEDH ZEKATIN TUAJ

Për zekatin në lekë:
 IBAN: AL 43 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLB
 Llogaria në lekë:
 IBAN: AL 70 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLA
 Llogaria në Euro:
 IBAN: AL 37 2051 6703 4163 29CL OTCF EURO
 Llogaria në Dollarë:
 IBAN: AL 81 2051 6703 4163 29CL OTCF USDA

Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë
 Tel: 0672304520 / 0672538334 / 048320160
 BKT Banka Kombëtare Tregtare
 Nr. i llogarisë : 52416329

Fetva / Rreth dhunës në familje

Akademia Ndërkombëtare e Fikhut Islam
Vendimi 180 (6/19)

Rreth dhunës në familje

Asambleja e Akademisë Ndërkombëtare të Fikhut Islam, e dalë nga Organizata e Konferencës Islamike, e mbledhur në sesionin e saj të nëntëmbëdhjetë, në Emiratin e Sharikas të shtetit të Emirateve të Bashkuara Arabe, në datat 1-5 Xhumadil Ula 1430 (26-30 Prill të 2009) pasi mori në shqyrtim studimet që i janë paraqitur Akademisë në lidhje me temën e dhunës në familje, pasi dëgjoi diskutimet që u zhvilluan rreth temës, pasi sollë në kujtesë parimet bazë dhe të patjetërsueshme të fesë, të cilat synojnë forcimin e shtyllave të familjes mbi bazën e dashurisë dhe dhembshurisë, ligjërimin e dispozitave të cilat përmbushin qëndrueshmërinë dhe qetësinë e familjes dhe se largimi nga kjo rrugë çon në përhapjen e dhunës në familje, vendosi si më poshtë:

Së pari: koncepti i dhunës në familje

Me dhunë në familje kuptojmë veprime ose fjalë të ashpra dhe të vrazhda që një individ i familjes ushtron ndaj një pjesëtari tjetër të familjes, të cilat i shkaktojnë familjes ose një individ të saj dëme fizike ose kuptimore.

Kjo sjellje është e ndaluar (haram), sepse ajo bie ndesh me objektivat e fesë islame për mbrojtjen e jetës dhe shëndet mendor, si dhe është në kundërshtim me rrugën hyjnore që bazohet tek sjellja e mirë dhe dashamirëse.

Së dyti: Në këndvështrimin islam, nuk konsiderohen dhunë dhe as diskriminim situatat e mëposhtme:

- Përmbajtja ndaj dispozitave të fesë që rregullojnë marrëdhëniet bashkëshortore.
- Paralajmërimi dhe refuzimi i formave joislame të martesës.
- Ndalimi i përdorimit të mjeteve kontraceptive për ata që nuk janë martuar, sipas normave që lejon Islami.
- Ndalimi i abortit, me përjashtim të rasteve emergjente shëndetësore të përcaktuara fetarisht.
- Fajësimi i deviancave seksuale.
- Ndalimi i gruas nga ana e burrit të saj për të udhëtuar vetëm, me përjashtim të rasteve kur udhëtimi bëhet me lejen e tij dhe përmbushen kriteret fetare.
- E drejta fetare që u njeh të dy bashkëshortëve për të ruajtur nderin dhe përmbushur nevojën seksuale mes tyre edhe në rastet kur dikush prej tyre nuk ka dëshirë.
- Mbajtja nga ana e gruas e rolit të saj kryesor si nënë dhe kujdestare e shtëpisë bashkëshortore dhe e burrit si përgjegjës për detyrimet e mbarëvajtjes familjare.
- Kujdestaria e tutorit, e njohur fetarisht, ndaj vajzës së virgjër në rast martesë.
- Ajo që ka përcaktuar feja islame në lidhje me trashëgiminë dhe testamentin.
- Divorci që kryhet në përputhje me kriteret e përcaktuara fetare.
- Poligamia e bazuar në ruajtjen e drejtësisë (sociale).

Së treti: Rruga islame për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve bashkëshortore

Gjatë trajtimit të mosmarrëveshjeve bashkëshortore dhe në veçanti mosbindjes dhe sjelljes së keqe nga ana e bashkëshortes duhet të kihet parasysh kriteret e mëposhtme fetare:

- Shmangia e sharjeve, ofendimeve dhe përçmimit.
- Kur burri e trajton problemin vetë me bashkëshorten, ai duhet t'i përmbahet metodës fetare normë, duke e nisur me këshillimin më pas me bojkotin dhe në fund me rrahjen e padhunshme, e cila në fakt qëndron më afër paralajmërimit sesa veprimet konkret, por natyrisht përdorimi i këtij mjete nuk është ai që këshillohet, sepse Profeti (alejhi salatu ue selam) ka thënë: "Më të mirët në mesin tuaj nuk rrahin" dhe vetë ai gjithashtu nuk ka rrahur asnjëherë ndonjë grua.
- Kur situata bëhet problematike dhe acarohet së tepërmi atëherë kërkohet ndërhyrja e dy njerëzve të tjerë për të arbitruar zgjidhjen e problemit.

4. Divorci duhet të kryhet sipas rregullave të përcaktuara nga sheriat dhe ashtu siç i përcakton ai (divorc i kthyeshëm, ndarës i madh ose i vogël, koha kur ai kryhet) dhe duhet të konsiderohet si hallalli më i urryer tek Allahu.

Së katërti: Akademia konfirmon se:

- Në nivelin familjar:
 - Rruga e zhvillimit shoqëror duhet të kalojë nëpërmjet edukimit fetar
 - Në ndërtimin e familjes duhet të theksohen parimet bazë të fesë, siç është bashkëpunimi, dashuria, dhembshuria, mëshira, qetësia, bamirësia dhe sjella e mirë mes dy bashkëshortëve.
 - Dialogu duhet të jetë baza e zgjidhjes së problemeve të brendshme familjare.
- Në nivelin institucional dhe shtetëror:
 - zhvillimi i kurseve dhe seminareve për ndërgjegjësimin e rreziqeve që mbart dhuna në familje si dhe edukimi i metodës së dialogut si metodë bazë.
 - Institucioneve edukative u del si detyrë tu mësojnë njerëzve sesi trajtohen çështjet e dhunës në familje, të çfarëdo forme ato qofshin...

Burimi: <http://www.fiqhacademy.org.sa>

Akademia e Fikhut Islam në Mekë
Sesioni i tretë / vendimi i parë
Data: 30/04/1400h ose 18/03/1980 e.s.

Kufizimi i lindjeve

Asambleja e Akademisë së Fikhut Islam, mori në shqyrtim temën e kufizimit të lindjeve ose siç quhet ndryshe në mënyrë eufemike "planifikimi familjar" dhe pasi diskutoi dhe shkëmbeu idetë rreth kësaj çështje vendosi njëzëri si më poshtë:

Nisur nga fakti se feja islame nxit në shtimin e pasardhësve muslimanë, në përhapjen e tyre dhe i konsideron ata si një mirësi e madhe e Zotit për krijesave të Tij, fakt i cili provohet në mjaft tekste islame: nga Libri i Allahut dhe Suneti i Profetit, të cilat provojnë se kufizimi i pasardhësve apo ndalimi i shtatzënisë bie ndesh me natyrshmërinë e lindur njerëzore, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit, si dhe bie ndesh edhe me kodet islame që Allahu ka zgjedhur për krijesat e Tij, nisur dhe nga fakti se propaganduesit e kufizimit të lindjeve apo ndalimit të shtatzënisë janë njerëz që synojnë të komplotojnë kundra muslimanëve, duke dashur të pakësojnë numrin e tyre në tërësi dhe në veçanti numrin e popujve të dobët dhe atyre arab e musliman, për ta pasur më të lehtë kolonizimin e vendeve të tyre dhe skllavërimin e tyre që mbeten dhe për të përfutur nga pasuritë natyrore të vendeve islame, nisur dhe nga fakti se një praktikë e tillë i ngjan veprimeve të kohës së injorancës para-islame dhe mbështetet mbi mendimin e keq për Allahun, si dhe synon dobësimin e strukturës islame, që përbëhet nga një shumësi gurësh njerëzorë të lidhur mes tyre, nisur nga të gjitha këto Asambleja e Akademisë së Fikhut Islam vendosi njëzëri se:

Nuk lejohet kufizimi i lindjeve në mënyrë absolute.

Nuk lejohet ndalimi i shtatzënisë, nëse kjo vjen nga synimi për të shpëtuar nga varfëria, sepse Allahu i Plotfuqishmi është Ai që i furnizon krijesat "Nuk ka krijesë të gjallë në tokë që të mos e ketë furnizimin e përshtatur nga Allahu", apo edhe për shkaqe të tjera të cilat nuk kanë peshë në këndvështrimin islam.

Për sa i përket rasteve individuale për shtyrjen e shtatzënisë apo ndalimin e tyre, për shkak të dëmit të sigurt, si për shembull në rastet kur gruaja nuk lind në mënyrë normale, por detyrohet të lind me operacion për nxjerrjen e fëmijës, në të tilla raste nuk ka pengesa fetare (për aplikimin e ndalimit apo shtyrjes së shtatzënisë).

Ky gjykim, për shtyrjen e shtatzënisë, vlen edhe për raste të tjera të justifikuar fetarisht ose nga ana mjekësore, të cilat përcaktohen nga një mjek i besueshëm musliman. Madje ka raste kur ndalimi i shtatzënisë është i detyruar, nëse provohet realisht se kjo e dëmton nënën, kur vihet jeta e saj në rrezik, fakt ky që duhet të provohet me raport mjekësor nga mjekë të besueshëm muslimanë.

Ndërsa për sa i përket kufizimit të lindjeve apo ndalimit të shtatzënisë në mënyrë të përgjithshme: në gjykimin islam ato nuk lejohen, për arsye që përmendëm më sipër. Por, më e rëndë se kjo është gjynahu në rastet kur njerëzit detyrohen me imponim të veprojnë në mënyrë të tillë, ndërkohë që në të njëjtën kohë shpenzohen pasuri të pallogaritshme në garën botërore të armatimit, me të cilat synohet shkatërrimi dhe supremacia globale, në vend që këto pasuri të shpenzohen për zhvillimin ekonomik dhe nevojat jetike të popujve.

Burimi: <http://www.themwl.org/Fatwa/default.aspx?d=1&cid=80&l=AR&cid=13>

Gazeta LIDHJA - e përtrejavshme

Bordi botues:
Justinian Topulli
Genc Plumbi
Mustafa Tërniqi

Redaktor përgjegjës:
Roald A. Hysa

LIDHJA HOXHALLARËVE TË SHQIPËRISË

Unaza e Re, Rruga: Teodor Keko mbi Alfa Bank, Tirane-Shqipëri
lidhjahoxhallareve@yahoo.com
Tel & Fax: +355 (0)48320160
<http://www.lidhjahoxhallareve.com>

Oazi i shpirtit / Froni i qiellit dhe froni i tokës

Nga Ibn Kajim el-Xheuzije



Krijesa më e përsosur, më fisnike, më madhështore, më e ndritur, më e larta në vend e pozitë dhe më e madhja është Arshi (froni) i Allahut, ndaj dhe Allahu i Madhëruar u lartësua mbi të. Krijesat e tjera, sa më afër Arshit që të jenë krijuar, aq më fisnike, të ndritshme dhe të përsosura janë në krahasim me të tjerat, që ndodhen më larg, për këtë arsye Xheneti i Firdeusit

është xheneti më i lartë, më i miri dhe më i ndritshmi, sepse ai është më pranë Arshit, e Arshi është çatia e tij. Çdo gjë, sa më larg tij të ndodhet, aq më e errët dhe e ngushtë është në krahasim me të tjerat, prandaj dhe më i poshtmi i të poshtmeve është vendi më i keq dhe më i ngushtë dhe larg çdo të mire. Allahu i ka krijuar zemrat dhe i ka bërë ato vendnjohtjen e Tij; në to vendoset dashuria

Frenimi i mllëfit dhe falja ndaj njerëzve

Me emrin e Allahut të Lartësuar.

Allahu thotë: "...që frenojnë mllëfin, që u falin (të keqen) njerëzve, e Allahu i do bamirësit." Ali Imran 134.

Gjithashtu Allahu ka thënë: "Ti je i butë ndaj atyre vetëm nga mëshira e Allahut, por sikur të ishe i ashpër dhe zemërfortë do të iknin prej rrethit tënd. Prandaj faljau dhe lutu të jenë të falur dhe konsultohu me ata në punë..." Ali Imran 159.

Muhamedi alejhi selam ka thënë: "Kush e përmban hidhërimin e tij, Allahu ia mbulon të metat, dhe kush përmban mllëfin e tij, edhe pse ka mundësi të hakmerret, Allahu ia mbush zemrën me shpresë Ditën e Gjykimit". Silsile Sahihah e shejh Albanit-Allahu e mëshiroftë.

Njeriu në këtë jetë të dunjasë është në sprovë, sado që mundohet të jetë i drejtë në raport me njerëzit dhe të shpëtojë nga e keqja e tyre në fjale dhe vepër, le të jetë i qëndrueshëm për shkak të divergjencave të njerëzve.

Muhamedi alejhi selam ka thënë: "Njerëzit janë si metalet e arit dhe argjendit". Muslimi.

Ka mundësi të gjejë ftohje prej shokut, apo ashpërsi dhe vrazhdësi në fjalët e fqinjët, e që prej kësaj nuk ka shpëtuar askush, e sikur të shpëtonte, do të shpëtonte Muhamedi alejhi selam, i cili ishte i butë, i qetë, i mëshirshëm, i afërt me njerëzit, bujar, por megjithatë edhe ai hasi në: keqtrajtim, izolim, largim, gurezë, saqë i rrodhi gjak nga dy këmbët e tij të ndershme. Kur i shkon atij Meleku

i Kodrave dhe i thotë: -Nëse dëshiron do t'i bashkoj atyre dy malet,- ndërsa i Dërguari i Allahut i përgjigjet: -Shpresoj që Allahu të nxjerr nga palca e tyre pasardhës, që do ta adhurojnë Allahun një të vetëm, duke mos i bërë shok.- Buhariu dhe Muslimi.

Kjo nuk është gjë tjetër pos praktikim i fjalës së Allahut, ku thotë: "Ti merri me të mire, urdhëro për vepra të mira dhe hiq nga injorantët!" - Araf 199.

Po ashtu rasti i beduinit, që e kishte kapur të Dërguarin e Allahut për rrobash, duke e tërhequr me forcë, saqë kishte lënë shenja në qafën e të Dërguarit, duke i thënë: -Më dhuro nga pasuria e Allahut që ti zotëron.

Islami na nxit në pajtimin mes armiqve, dhe në këtë rast ka lejuar edhe gënjeshtren, për shkak të realizimit të interesave të përgjithshme: largon zilinë, urrejtjen, armiqësinë dhe derdhjen e gjakut, e në vend të saj mbjell: dashurinë dhe butësinë, paqen, sigurinë. E gjithë kjo bëhet duke falur dhe frenuar mllëfin, e me këtë arrihet një mirësi e madhe dhe mënjanohet një e keqe e madhe.

Vëllezër të nderuar: le të ruhemi nga sprovat, qofshin ato sprovat të çështjeve të kësaj bote, apo sprovat për të cilat nuk di askush tjetër pos Allahut. O Allah, ne kërkojmë mbrojtje nga sprovat, ato të dukshmet dhe të padukshmet. Amin.

Përshtati: Valdet Kamberi

për Allahun. Zemra është froni (arshi) i shembullit më të lartë, që është pikërisht njohja e Tij, dashuria për Të dhe dëshira për t'u afruar me Të. Allahu i Lartësuar thotë: "Për ata që nuk besojnë në Botën e Përtejme, është përcaktuar shembulli i më të keqes, ndërsa Allahut i përket Shembulli më i lartë dhe Ai është i Gjithëfuqishmi, më i Urti Gjithëgjykues." (Nahl, 60), "Është Ai, i Cili e fillon krijimin, pastaj do ta përsërisë atë dhe kjo është shumë e lehtë për Të. Atij i takon shembulli më i lartë në qiej dhe në tokë. Dhe Ai është i Gjithëfuqishmi, më i Urti, Gjithëgjykues." (Rrum, 27), dhe Allahu thotë gjithashtu: "Asgjë nuk i shëmbëllen Atij". (Shura, 11).

Njohja, dashuria dhe dëshira për të qenë pranë Allahut është një prej shembujve më të lartë, që lartësohet në zemrën e besimtarit dhe është froni për të. Nëse zemra nuk është më e pastra, më e mira dhe më e largëta nga çdo e keqe, ajo nuk mund të bëhet vend i përshtatshëm për të qëndruar shembulli më i lartë në të, ndaj në të qëndron shembulli më i ulët, që është dashuria dhe varësia e zemrës pas kësaj bote, dhe kësodore, kjo zemër do të bëhet vendi më i ngushtë, më i errët dhe më i largët nga lumturia dhe përkryeshmëria.

Kështu do të kemi dy zemra, një

zemër e cila bëhet froni për Allahun (njohjen dhe dashurinë për Të), e në të cilën do të ketë jetë, dritë, ngazëllim, hare, lumturi dhe çdo gjë të mirë, por në anën tjetër do të kemi një zemër, e cila është bërë froni i shejtanit, dhe në të do të gesh ngushtësi, errësirë, vdekje, trishtim, ankth dhe stres. Një njeri i tillë do të jetë i pikëlluar për të shkuarën e tij, i merakosur për çastet që jeton dhe në ankth për atë që e pret në të ardhmen. Transmetohet një hadith nga Profeti (salAllahu alejhi ue selem), në të cilin thuhet: "Kur drita hyn në zemër, ajo hapet dhe zgjerohet." Shokët e tij e pyetën: 'Dhe si dallohet kjo o i Dërguari i Allahut?' Ai tha: "Dashuria për botën e përjetshme, urrejtja për botën mashtruese dhe përgatitja për vdekjen, para se ajo të vijë." (1)

Drita që futet në zemër, vjen si ndikim i shembullit më të lartë, ndaj dhe ajo hapet dhe zgjerohet, e nëse në të nuk ka njohje dhe dashuri për Allahun, atëherë në të do të ketë vetëm errësirë dhe ngushtësi.

Marrë nga el-Feuid fq. 36-37.

(1) Ky hadith transmetohet nga Hakimi 4/311 dhe të tjerë, por nuk është autentik (hadith daif); shih 'Ed-Daifetu' të shejh Albanit nr. 965.

Tre hadithe të vjera nga profeti ynë i dashur Muhamedi alejhis-salatu ue selam

Një burrë shkoi tek Profeti (alejhis-salatu ue selam) dhe i kërkoi leje për të shkuar në xhihad, ndërsa Profeti (alejhis-salatu ue selam) i tha: "A i ke të dy prindërit gjallë?" -Po- u përgjigj ai. Atëherë Profeti (alejhis-salatu ue selam) tha: "Shko bëje xhihadin tek ata të dy!" Buhariu dhe Muslimi.

Në një transmetim tjetër tregohet, se ai njeri kishte ardhur tek Profeti (alejhis-salatu ue selam), që të kërkonte leje për xhihad, por i kishte lënë të dy prindërit duke qarë. Atëherë Profeti (alejhis-salatu ue selam) i tha: "Shko tek ata të dy dhe bëji të qeshin ashtu siç i bërë të qajnë!"

"Xhihadi më i mirë është fjala e vërtetë përpara një prijësi zullumqar." Ebu Davudi.

Analizë / Disa faktorë që ndikuan në depërtimin e Islamit në trojet shqiptare

Nga Emërim Koçi

Gjurmët e para të Islamit në Ballkan, sidomos në trojet iliro-arbërore, i hasim që në mesjetë me intensitet më të fuqishëm dhe në pjesën e parë të kohës së re me intensitet maksimal. Përkatësisht, shenjat dhe gjurmët e muslimanëve të parë në Ballkan shpesh në periudhën kur popujt e sllavëve të jugut ende i përkisnin religjionit të tyre sllav, apo në kohën kur filluan të kristianizohen. Shkencëtari boshnjak M. Haxhijahiq pohon se “nëse kjo është e saktë, e mendojmë se për këtë ekzistojnë dëshmi, atëherë shfaqja e Kristianizmit të sllavët e jugut, ose të pjesa më e madhe e tyre, nuk është më e vjetër nga shfaqja e Islamit. Për më tepër disa grupe të sllavëve të jugut, që me ardhjen në Ballkan ende nuk kanë qenë të kristianizuar - nuk kanë qenë larg nga ajo që eventualisht ta pranojnë edhe Islamin”.


Këtyre kontakteve u kanë paraprirë ato të mëhershmet. Në mbështetje të shumë fakteve historike, gjuhësore e arkeologjike, shkencëtarët kanë përfunduar se kanë ekzistuar këmbime intensive të vlerave kulturore ndërmjet viseve jugore ilire dhe pellgut të Egjeut të Lindjes së Afërme. Në kontaktet e hershme të popujve tanë në Ballkan me popujt muslimanë kanë determinuar kushtet natyrore - gjeografike që i posedonin viset iliro-arbërore dhe viset e tjera ballkanike, që me mijëvjeçarë kanë pasur lidhje me vendet mesdhetare, posaçërisht me Lindjen e Afërme. Rrugët tokësore të ashtuquajtura transballkanike çonin drejt Lindjes. Rruga e njohur e mëndafshit, që lidhte Evropën - Ballkanin - dhe Persinë e Kinën, por edhe rrugët detare, kanë mundësuar që ushtarakisht, politikisht, ekonomikisht, si edhe në lëmin e kulturës të kenë kontakte reciproke me Lindjen e Afërme e të Mesme. Këto lidhje bëheshin përmes Detit Mesdhe, atij Adriatik dhe Detit Egje me luginën e Vardarit.

Faktorët kryesorë që ndikuan që kultura e qytetërimi islam të depërtonë, të mishërohen dhe të krijojnë traditë shumëshekullore në këto vise janë të llojllojshëm dhe çdonjëri, pak a shumë, ka luajtur rol të caktuar në suksesin e depërtimit të Islamit në këto troje.

1. Faktori fetar

Në historiografinë shqiptare, por edhe ballkanike, faktori fetar është shpërfillur në shqyrtimin dhe analizat rreth përhapjes së fesë islame të ne dhe në botë. Si rezultat të kësaj gjendjeje kemi injorimin e këtij faktori, ndonëse ky tërthorazi, mund të vërehet në raportet e relatorëve kristianë, kronistëve apo udhëpërshkruesve të ndryshëm.

Para së gjithash ky faktor konsiston në atë se Islami për herë të parë në histori i solli gjinisë njerëzore një koncept të plotë mbi Krijuesin dhe mbi krijesën. Ai nuk e ndan jetën, por e kupton si të



vlefshme e të bashkuar, që e rregullon jetën në tërësi. Islami, nëpërmjet Kuranit dhe traditës profetike ofron rrugëzgjdhje cilësore, si për nevojat shpirtërore ashtu edhe për ato materiale, sidomos në pikëpamjen gjithëpërfshirëse mbi botën, duke ofruar monoteizëm të pastër, legjislacion gjithëhapësinor dhe gjithëkohor (shariat) etj. Këtë po e ilustruam me fjalët e një udhëtari nga shkencëtarët anglezë: “Islami, vërtet është feja që pastron tokën prej idhujve. E ndalon flijimin e njeriut dhe ngrënie e mishit të tij. U garanton të drejta femrave, e kufizon poligaminë... i forcon lidhjet familjare. Robi dhe i robëruari bëhen një prej anëtarëve të familjes, u hapin atyre shumë rrugë e dyer për shpëtim dhe liri. Moralit e përgjithshëm e pastron me forcën e themeleve të tij, si namazi, zekati, nderimi i mysafirrit dhe siguria e udhëtarit... Parinë e mëson se kanë detyra sikurse populli ... Këto janë një pjesë nga begatitë e shumta që gjithmonë e përcjellin Islamin me rastin e pushtimit të popujve të paqytetëruar.” Gjatë historisë, e sidomos deri në kohën e Muhamedit a.s., koncepti i monoteizmit kishte degraduar thellësisht. Kjo gjendje mbretëronte edhe në trevat ballkanike, sidomos në ato iliro-arbërore.

2. Faktori moralo-etik

Ideali i edukimit dhe i mirësjelljes ka qenë dhe ka mbetur fort i shprehur në të perceptuarit islam të shoqërisë, që ka lënë gjurmë të thella edhe në kulturën e tij shpirtërore e materiale.

Morali i individit ndërtohet dhe dëshmohe në bashkësi, ku individit e vet Allahut dhe amanetin e pranuar ta zbatojë në vete, në familje, në rreth më të ngushtë (xhemat) dhe bashkësi më të gjerë, heterogjene sipas prejardhjes dhe bindjeve. Motoja që për muslimanët paraqet një simbol “Jepi përparësi vëlait tënd para vetes”, hap një kapitull të ri në raportet njerëzore, që konsiston se muslimanët çdo gjë e mbështesin në dashuri, harmoni, drejtësi, barazi dhe solidarizim reciprok. Kurani refuzon kriteret e tjera jostabile dhe pagane, si racën, ngjyrën ose gjuhën dhe vendos një kriter jashtë barrierave hapësinore e kohore - kriterin e takvallëkut (devotshmërisë).

Islami vë në veprim një postulat shumë me rëndësi: Urdhëresa për të mirë dhe ndalesa e së keqes. Ky element i ri e ka bërë muslimanin fuqi kreative, që nuk ndalet vetëm në pyetjet e besimit, moralit ritual dhe personal, sepse aksioni është pjesë e fesë, dhe se Zotit nuk i intereson vetëm në çka beson dikush, por edhe çka vepron ai.

Në anën tjetër, për shkak të refuzimit të Jezusit nga hebrenjtë, Kristianizmi ka humbur legjislacionin hyjnor, që do të administronte çështjet jetësore të botës. Ungjilli u nda nga Torahu, dhe kështu Kristianizmi mbeti vetëm në pikëpamje shpirtërore e emocionale. Ndheshja e këtyre dy mësimëve normalisht që ndikoi aq sa gjendja të zbutet në favor të Islamit.

3. Faktori kulturor-shkencor

Islami është fe që nuk i njeh mitologjinë dhe besëtytnitë. Mësimet e tij janë të rëndësishme dhe mbarëbotërore. Islami i drejtohet arsyes dhe vetëdijes njerëzore.

Allahu ia bëri njeriut obligim të parë mësimin dhe përdorimin e lapsit, kurse për kriter vendosi devotshmërinë. Dijetarët lartësohen në nivele të larta. Në themel të këtyre parimeve, kultura dhe qytetërimi islam me sukses veprojnë plot 14 shekuj. Ata nuk kanë rrënuar, siç veproun mongolët në Bagdad dhe të krishterët në Spanjë, kryqtarët në Lindjen e Afërt, romakët në trojet e Mbretërisë Ilire e në Greqinë antike, por kanë absorbuar shumë të arritje pozitive të kulturave e qytetërimeve më të hershme, i kanë mbrojtur nga harresa e zhdukja ato, si fjala vjen filozofinë greke etj. Ndarjen në dituri fetare dhe jofetare Islami e njeh, i jep rëndësi të rangut të parë dijes fetare, dhe në të njëjtën kohë nuk i anashkallon dijet shkencore. Muhamedi a.s. thotë: “Kush del nga shtëpia për shkak të kërkimit të diturisë, konsiderohet se është në rrugën e Allahut, derisa të kthehet nga rruga.” (Tirmidhiu). Ky hadith vërtet që ka si qëllim dijen fetare, por nuk do të thotë që përjashton dijet e tjera. Pra kjo tregon qartë se dija, kultura, shkencë, mirëkuptimi, toleranca, barazia para Zotit kanë qenë faktorë kryesorë në islamizimin e pop-

ullit tonë.

4. Faktori politiko-ekonomik

Qarqe të ndryshme keqdashëse janë përpjekur që ta reduktojnë Islamin në fe emocionesh e çështjesh private, duke e zhveshur nga çdo element politiko-ekonomik. Prezentimi i këtyre elementeve dhe implikimi i tyre në përditshmëri është etiketuar me shprehje nga më ekstremet. Është dëshiruar të arrihet një farë baraspeshe ndërmjet Kristianizmit dhe shumë religjioneve të tjera, që në doktrinën e tyre nuk e posedojnë këtë segment si në Islam.

Faktori politiko-ekonomik në Islam zë fill në katër parime kryesore:

1. Parimi i parë i sistemit politik islam është që pushteti suprem i shtetit i përket Zotit, kështu që Islami e siguron drejtësinë unike dhe është kundër marrjes së vendimeve tendencioze arbitrare e të ngjashme.

2. Parimi i dytë i sistemit politik islam është që të gjithë njerëzit janë të barabartë para ligjit, sikurse edhe para Zotit. Kësaj i nënshtrohet edhe personaliteti më i lartë në shtetin islam - halifi. Rasti i Aliut r.a. është tipik, pastaj i emirit Amr ibn Asit me hebreun para Omerit r.a. etj.

3. Parimi i tretë i sistemit politik islam është, që të gjitha punët me rëndësi të përgjithshme i janë besuar Allahut, kurse sunduesi sundon në suaza të urdhrave të Zotit dhe udhëzimeve të Të Dërguarit a.s., e për të mirën e përgjithshme.

4. Parimi i katërt i sistemit politik islam është që të gjitha punët shtetërore të vendosen me marrëveshje, madje duke e dëgjuar edhe mendimin e qytetarëve. Me këtë rast nuk do të flasim për liritë veç e veç, si liria e të shprehurit, e mendimit, e lëvizjes, e drejta për punë, e drejta aktive e pasive në zgjedhje, e drejta për shkollim etj., sepse do të na çonte shumë larg.

5. Faktori shoqëror

Kontaktet e muslimanëve me popujt ballkanikë, kristianë e paganë, gjetën një situatë tejet të rëndë shoqërore. Kriteret e vetme ishin forca, shtypja e shfrytëzimi, si individual ashtu edhe ai institucional. Sundimi i vazhdueshëm i fuqive të ndryshme kishte krijuar kaos shoqëror: romakët, bizantinët, bullgarët, sllavët, serbët. Në anën tjetër, muslimanët e parë në Ballkan sollën një botëkuptim tjetër për shoqërinë. Islami i refuzon kriteret artificiale, jo të drejta dhe e nxjerr njerëzinë nga mituria në madhori. Në anën tjetër, nëpërmjet namazit, agjërimit, zekatit, haxhit e shtyllave të tjera në vazhdimësi krijon ndjenjën e barazisë shoqërore. Islami ka vënë rregulla edhe në aspektin e lidhjeve të mira farefisnore dhe fqinjësore, por ndalon nepotizmin, kurse ndihmesën pa kriter të të afërmit e konsideron in-

Histori / Palestina dhe fillimi i erës islame

Në 638 e.r., kur muslimanët hynë në Palestinë, ishte “një pushtim i lehtë” siç e përshkruan historiani arab Baladhuri. Ishte një çlirim sepse nuk ishin arabët që po vinin, por Islami. Arabët kishin qenë aty për më tepër se tre mijë vjet: Amoritët, Kananitët e të tjerë me origjinë dhe kishin migruar nga Gadishulli Arabik. Në 638-ën një valë e re migrantësh prej Arabie solli Islamit.

Muslimanët nuk e konsiderojnë Islamit si një besim midis të tjerëve, por si përmbushjen e mesazhit hyjnor tashmë të zbuluar. Në Librin e Zbulesës të Islamit ne lexojmë urdhërin që pason:

“Thuaj: Ne i kemi besuar Allahut, edhe asaj që na u zbrit neve edhe asaj që i është zbritur Ibrahimit, Ismailit, Isakut, Jakubit dhe pasardhësve. Edhe asaj që i është dhënë Musait dhe Isait, edhe asaj që u është zbritur të gjithë pejgamberëve nga Zoti i tyre. Ne nuk bëjmë kurrfarë dallimi në mes tyre dhe ne vetëm Atij i jemi dorëzuar”. (Kurani, 3:84).


Kështu që Islami iu shfaq hebregjeve në Palestinë si trashëgimtar i Ibrahimit dhe i Musait, dhe të Krishterëve si Jezusi i ndershëm – jo si hipostaza greke e Nikeas - por si një i Dërguar i Zotit, si një profet, një apostull, dhe një Mesih, i lindur nga një virgjëreshë:

“Mesihu Isa, bir i Merjemes, ishte vetëm i dërguar i Allahut. Ishte fjalë e Tij (bëhu) që ia drejtoi Merjemes dhe ishte frymë (shpirt) nga Ai”.

E krahasuar me intolerancën e perandorëve bizantinë, ardhja e Islamit ngjau si një çlirim për Hebregjtë dhe të Krishterët ‘heretikë’, ose e thënë me fjalë të tjera, për pothuajse të gjithë popullsinë e asaj zone përveçse për pushtuesit Greko-Bizantinë. Kjo është arsyeja që kur Muslimanët hynë në Palestinë e Siri, ato u mirëpritën nga masat si çlirimtarë. Tashmë populli ishte i përgatitur fetarisht për monoteizmin e pastër Islam, që i njihte Abrahamin, Moisiun dhe Jezusin si të dërguar të Zotit dhe si pararendës të profetit të fundit Muhamedit.

Kronikani hebre Bar Hebreus thërriste: ‘Zoti i dërgoi Arabët të na çlironin nga Romanët. Ne shpëtuam nga mizoria e Grekëve, dhe urrejtja e tyre për ne’.

Fanatizmi shtypës i perandorëve na ndihmon neve të kuptojmë pse fati i këtij vendi u ndryshua kryekëput në betejën vendimtare të Jarmukut më 20 gusht 636. Edhe përpara betejës një rebelim i kishte ndarë më dysh Armenët e Krishterë me ushtrinë perandorake. Në kulmin e betejës, Siriano-Arabët e Krishterë u tërhoqën, kështu që pushtuesit Grekë u gjendën duke luftuar të vetëm dhe u shpartalluan totalisht. Ushtritë Muslimane mbritën në Damask pa incidente të mëtejshme. Në Jeruzalem patriarku ortodoks Sofroni kërkoi paqe me kusht që Kalifi Omer ibn Hatabi të vinte vetë në qytet dhe t’i garantonte personalisht pikat e paqes. Historianët arabë na tregojnë që Kalifi duke hyrë në Jeruzalem me thjeshtësinë dhe modestinë më të madhe nuk e pranoi ftesën e Patriarkut për t’u falur në një nga kishat e qytetit. Kishte frikë, shpjegoi ai, se mos Muslimanë tepër të zellshëm mund ta



përdornin këtë si një pretext për të ngritur një xhami në vend të kishës për të përkujtuar kalimin e tij.

Të vetmit ata që duhej të largoheshin nga Palestina ishin ish-pushtuesit grekë.

Kalifi nxorri një proklamata, ku i thërriste të gjithë Popujt e Librit (Hebregjtë, Krishterët dhe Muslimanët) të bashkoheshin. Ai garantonte sigurinë e të gjithë banorëve dhe të pronave të tyre dhe këmbëngulte në respektin e duhur për murgjërit e krishterë: ‘Mos i bezdisni ata që jetojnë të tërhequr nga bota, kështu që ata të mundin të vazhdojnë të përmbushin betimin e tyre.

Raportit e përmbledh situatën kështu:

Na duhet të pranojmë që, në fillimet e Mesjetës një proklamata e tillë, e cila në tërësi është me respekt nga Trupat Muslimane është shumë e moderuar. Ata ishin dukshëm më të drejtë dhe tolerantë. As perandorët e Bizantit as peshkopët e Kishës nuk kishin shprehur ndonjëherë ndjenja të këtitilla në emër të dikujt që predikonte një besim të dashurisë. Një dokument si proklamata e Kalifit (thirrja e kalifit Omer, ‘sh.p.’) duhet të ketë bërë një përshtypje të thellë jo vetëm në Hebregjtë por edhe te të Krishterët. Të parët kishin pësuar shtypjen, ndërsa të pasmit ishin persekutuar nga shteti i Kishës për pikëpamjet e ndryshme fetare. Të gjithë ata, përveç kësaj, kishin qenë nën varësinë e zgjedhës së nënpunësve civilë dhe ngarkesën e taksave të rënda.

Politika e Kalifëve ishte ishte aq liberale sa që të krishterët si Mensur ibn Sarjun dhe më pas djali dhe nipi i tij (sot i njohur si Shën Gjon Damaskeni), ushtruan funksionin e Kontrollorit Kryesor të Financave. Secili nga këta burra u bë figura e dytë më e lartë në qeverisjen muslimane.

Kjo përbën një kontrast goditës me fanatizmin e perandorëve të krishterë bizantinë. Kur Shën Gjon Damaskeni, në kohën që ikonoklazma 2 nuk mund të ndalohej, shkruajti një libër për t’u admiruar teologjik për ikonat, perandori

e kalifëve, të krishterët palestinezë gëzuan për shekuj të tërë paqe e begati.

Hebregjtë, gjithashtu, filluan të lulëzojnë. Akademia e Tiberias, ku traditat gojore hebraike qenë mbledhur në Talmudin, tashmë mund të transferohej në Jeruzalem. Këtu jeta intelektuale hebreje u bë më e fortë dhe influencuese: Testamenti i Vjetër Hebraik u hodh në letër përfundimisht në versionin e tij (Mazoretik), dhe poema të mrekullueshme liturgjike të njohura si piyyutim u kompozuan. Shumë Hebregj u ngritën në pozita të larta të fuqishme, si Manaseh ben Hazra, që u bë guvernator i Damaskut. (Është interesante të vërehet se në të njëjtën kohë, një i Krishterë, Isa ibn Nestorius ishte kryeministër).

Turbullira më e madhe në gjithë këtë peisazh në 950 e.r., kur Niqifor Fokasi i Bizantit pushtoi Palestinën. Sipas Raportit, ‘ai theri banorët, dogji shtëpitë, preu pemët frutore dhe i shiti burra e gra si skllëvër. Mund të thojë me plot gojë që Vendet e Shenjta u kthyen në shkretëtirë nga duart e të krishterëve’. Me këtë përfundim dhe ndonjë tjetër, periudha e hershme Islame mund të konsiderohet si periudha më me fat e Palestinës.

1) Hipostazi – term me të cilin nënkuptohet bashkimi i natyrës njerëzore me atë hyjnore në personin e Jezu Krishtit (Isa a.s.), prej të krishterëve.

2) Ikonoklazma – Ikonathyes, lëvizje që e përshkoi Perandorinë Bizantine dhe arriti të zyrtarizohej përrreth një shekull të tërë, rreth viteve 700-800 të erës sonë.

3) Anatema – Mallkim, çkishërim.

Marrë nga libri *Palestina- grup autorësh*

VERANDAT OSMANE NË QABE NUK DO TË PRISHEN

Tashmë janë të sigurt Portikët (verandat) osmane përreth Qabesë, vendit të shenjtë për botën islame. Në këtë proces, kanë qenë efektive jo vetëm përpjekjet e autoriteteve më të larta të Arabisë Saudite, por edhe ato të shoqërisë civile. Verandat osmane të cilat janë të mbyllura lart por që pjesa e përparme mbetet e hapur, vihen re shpesh në arkitekturën osmane dhe sidomos nëpër xhami. Shembulli më prestigjioz i verandave është përreth vendit të shenjtë për muslimanët, Qabesë. Këto veranda që ishin në rrezik për shkak të restaurimeve në kuadër të projektit të zgjerimit, tashmë janë të sigurta. Ato nuk do të shemben, dhe mbrohen me kujdes nga ana e kompanisë turke që ka sipërmarrë restaurimin. Në këtë proces, efektive kanë qenë jo vetëm sugjerimet e Presidentit Gyl dhe Kryeministrit Erdoan me autoriteteve më të larta të Arabisë Saudite, por edhe ato të shoqërisë civile. Burimet përkatëse në lidhje me këtë temë theksojnë se sjellja e verandave në Turqi nuk bëhet fjalë. Ato do të mbrohen në vendin ku ndodhen.



Rruga drejt vendtakimit të dy deteve

Nga Neki Kaloshi

Allahu xh.sh. thotë në Kuranin e Tij Famëlartë: 65. Dhe gjetën një prej robërve Tanë, të cilit i patëm dhuruar mëshirë prej Nesh dhe i kishim mësuar nga ana Jonë dije. 66. Musai i tha atij: "A mund të të pasoj ty, që të më mësosh edhe mua diçka prej diturisë së drejtë që të është dhënë ty?" 67. Ai u përgjigj: "Ti nuk mund të durosh dot me mua! 68. E si mund të durosh (pa pyetur) para diçkaje për të cilën nuk di asgjë?" 69. (Musai) tha: "Do të më gjesh të durueshëm, në dashtë Allahu e nuk do të të kundërshtoj për asgjë." 70. (Hidri) i tha: "Nëse vjen pas meje, mos më pyet për asgjë, derisa të ta shpjegoj unë!"

Prej këtyre ajeteve ka vërtetë shumë mësim për këdo që kërkon të marrë dije dhe të veprojë me të. Dija është një prej vetive më të larta që e zbulon njeriun dhe e ngre atë në gradë të larta tek Allahu xh.sh. Zoti thotë në Kuran: "Me të vërtetë njerëzit që i frikësohen më shumë Allahut janë dijetarët". Kjo vjen si rezultat i dijes së tyre mbi madhësinë e Allahut, si rezultat i dijes mbi cilësitë e Tij të larta dhe mirësitë e Tij të pafundme ndaj robërve të Tij, por vjen edhe si rezultat i dijes mbi dobësitë e tyre si krijesa. Pra frika ndaj Zotit vjen mbi bazë të dijes së njeriut në dy drejtime: Dija ndaj fuqisë së Zotit, dhe dija ndaj mangësisë nejrëzore. Dija e njeriut në këtë rast i bën të qartë atij kontrastin e madh midis krijesës dhe Krijuesit. Vetëm kështu njeriu arrijn të kuptojë vërtetë nevojën e madhe që ka për Krijuesin e tij, dhe vetëm kështu ai i nënshtrohet Atij plotësisht. Në të vërtetë kuptimi i fjalës musliman është, "i nënshtroar". Dhe nënshtrimi vjen pikërisht kur robi kupton këtë kontrast krijesë-Krijues. Por, rruga për tek dija është e vështirë dhe kërkon që njeriu të jetë i pajisur me një sërë cilësish dhe vlerash. Imam Shafiu citon mësuesin e tij të thotë:

"Dija është dritë dhe Allahu nuk ua jep dritën atyre që nuk dinë ta vlerësojnë". Një ndër cilësitë më të rëndësishme që i bën të mundur njeriut të arrijë dijen është durimi. Me durim këtu kuptojmë një sërë elementësh: durimi në përzgjedhjen e njerëzve nga e merr dijen, durimi në preokupimin dhe sakrificat për ta marrë dijen (sakrifikimi i kohës, mundit, privimit nga dëshirat madje edhe nga shumë prej nevojave të njeriut), durimi për të qenë i vëmendshëm ndaj mësimin, durimi për ta ruajtur dijen pasi e ke marrë atë (durimi për të rezistuar ndaj harresës), durimi për ta zbatuar atë që mëson, durimi për t'ua transmetuar atë të tjerëve si dhe durimi për ta mbrojtur dijen nga cdo gjë që e prish atë, sic mund të jenë idetë e gabuara, sulmet e injorantëve, etj.

Dija është dhurata më e madhe që Allahu i jep besimtarit, por që njeriu të arrijë tek kjo duhen një sërë kushtesh. Cdo mirësi që Allahu ua jep robërve të tij ka nevojë për kushtet e veta. Ka nevojë për kohë, për mund, për sakrificë dhe bereqet ka nevojë që të pëqet deri sa të mbërrijë tek nejrriu. Dija është si fara që mbillet në tokë dhe ajo ka nevojë për kohën dhe kushtet e saj, deri sa të japë frutet e veta. Gjatë kësaj kohe, njeriu duhet të kujdeset për të, të përpqet, të sakrifikojë që pema e tij të rritet e sigurt deri në kohën kur ajo sjell bereqetin e saj. Nuk ka rrugë të shkurtra dhe të menjëhershme për këtë. Këto janë ligjet e Zotit dhe njeriu duhet tu nënshtrohet atyre, nëse dëshiron të ketë sukses në këtë jetë dhe në tjetrën. Profeti a.s. thotë: "Zoti më edukoi mua dhe e përsosi edukimin tim". Si e përsosi Allahu edukimin e Profetit a.s.? Që në vegjëli ia pastroi zemrën nga mëkatet. Allahu i Lartësuar thotë: "A nuk ta pastroam ne gjoksin tënd?". E dyta, duke e ruajtur Profetin e Tij nga mëkatet që përpara shpalljes. E treta, duke i dërguar atij mësuesin më të mirë, Xhibrilin a.s. E katërta, duke i lënë atij një interval kohor prej 23 vjetësh. E pesta, duke ia për-

shtatur dijen në raport me situatat e krijuara gjatë jetës së tij. Dhe i gjithë mesazhi i Profetit a.s. fillon me fjalën "lexo" dhe përfundon me "Sot plotësova për ju fenë tuaj dhe plotësova për ju mirësinë Time". Pra mesazhi ka filluar me leximin dhe është përsosur gradualisht deri në momentin e fundit, kur misioni profetik i Muhamedit a.s. përmbushet krejtësisht. E gjithë kjo kohë ka kaluar nëpërmjet një kalvari të gjatë sakrificash, mundimesh, përpjekjesh, në të cilat Profeti a.s. ka dëshmuar se që më i durueshmi i të duruarve. Me kaq sa thamë deri më tani mund të kuptojmë se humbja e durimit është ajo cka privon robin nga dija. Humbja e durimit bën që njeriu ta vjelë pemën e tij, pa u pjekur frutet ende, dhe si rrjedhim ato nuk japin bereqet, por dëm. E gjithë kjo vjen nga një sifit shumë i keq që ka njeriu, nxitimi. Nxitimi prish gjithë mundin e bërë për arritjen e të mirës. Në këtë mënyrë njeriu as e arrin bereqetin, por ndërkohë e cdo dëm përpjekjen. Një fjalë e urtë thotë: nxitimi as nuk e arrin përfundimin dhe as e kursen kurrizin. Ndërsa një tjetër: Kush e kërkon dicka para kohe, ndëshkohet me mosrealizimin e saj. Profeti a.s. na këshillon: "Nxitimi është prej shejtani". Me një fjalë, shejtani përpqet të që me anë të nxitjes së nxitimit tek besimtarët tua prishë veprat atyre. Në rastin konkret, nëpërmjet nxitimit, shejtani i privon besimtarët nga dija, duke synuar ti lërë ata në errësirë. Shumë dijetarë kanë thënë se një dije e mbetur për gjysëm nuk është dije. Ajo sjell vetëm ngatërresa midis njerëzve dhe i corodit ata. Një ndër robërit më të dashur tek Allahu, i cili ka pasur privilegjin të bisedojë drejtpërdrejt me Allahun, është Musai a.s. Allahu i Lartësuar thotë në Kuran: "Dhe Allahu i folli Musait, fjalë bindëse". Duke qenë në këtë pozitë Musai a.s. mendoi se ishte neri më i ditur në tokë, dhe në një bisedë që pati me popullin e tij, e pohoi këtë. Për këtë pohim, Allahu i Lartësuar i tërhoqi vëmendjen.

E urdhëroi që të marrë rrugën për tek një njeri më i ditur se ai, të cilin as Musai nuk e dinte se ekzistonte. Dhe kjo rrugë ishte e gjatë dhe e mundimshme. Vendtakimi i tij me Hidrin ishte vendtakimi i dy detrave, një skaj i largët dhe i mundimshëm për tu përshkuar. Pas gjithë këtij mundimi, Musai a.s. e humbi rrugën dhe u desh të orientohej nëpërmjet peshkut. Pasi arriti tek Hidri, Musai u përball me skepticizmin e Hidrit, i cili iu shpreh se dyshonte nëse ai do të ishte i durueshëm. Ndërkohë, Musai, i vendosur për t'ia dalë mbanë mësimin. Ai iu shpreh Hidrit: "Dhe dashtë Zoti, do të më gjesh nga durimtarët".

Dhe kështu nis një tjetër rrugë e Musait a.s., ajo e kërkimit të dijes prej Hidrit. Gjatë këtij udhëtimit, mësuesi, bëri disa veprime që për Musain binin ndesh me arsyen e tij e cila ishte e kufizuar në një sferë tjetër nga ajo e Hidrit. Kjo bëri që Musai të ndërhynte duke shprehur habinë me sjelljen e tij, gjë që e bëri të shfaqë mosdurimin etij. Mësuesi e toleroi në rastin e parë. E toleroi edhe në të dytin. Pas rastit të tretë, ku dhe vetë Musai u bind për dobësinë e tij, për mungesën e durimit, kur edhe e mori mesazhin bindës prej Krijuesit të tij, se vërtetë paska njerëz edhe më të ditur se ai, u kthye tek populli i tij. Profeti Muhamed s.a.v.s.: "Zoti e mëshiroftë Musain. Sikur të kishte duruar edhe pak, Hidri do ti mësonte edhe shumë gjëra të tjera të vlefshme".

Kjo ngjarje është dëshmi e mënyrës me të cilën Allahut xh.sh. e ndihmoi të dërguarin e Tij, për tu kultivuar me kujdesin për të qenë i matur në cdo vendim që ndërmer, si dhe për të peshuar cdo fjalë dhe për të mos shprehur kurrë asgjë të nxituar dhe për të cilën nuk ka njohuri.

**Ky shkrim është një hutbe e mbajtur gjatë faljes së shumase në Xhaminë e Laprakes*

Pastrimi i parave dhe qëndrimi i Islamit ndaj saj

Allahu e ka krijuar njeriun me një natyrë që e pëlqen pasurinë dhe këtë të fundit Allahu e ka bërë zbulim për jetën e dynjasë. Për këtë arsye Allahu i Lartësuar ka urdhëruar që pasuria të ruhet dhe e ka renditur atë në një nga pesë domosdoshmëritë e jetës, ka ndaluar që ajo të shpërdorohet apo që të cenohet përmes vjedhjes, marrjes me dhunë apo mashtrimit. Për të arritur këtë qëllim Islami ka vendosur ndëshkime nga më të ndryshmet. Allahu i Lartësuar ia ka bërë të lehtë njeriut rrugën e fitimit të pasurisë dhe e ka nxitur atë të punojë, e ka ndaluar që ta fitojë atë nga rrugë të ndaluara dhe e ka kërcënuar, se do ta përballë atë me ndëshkime në këtë botë dhe në tjetrën. Një pasuri të tillë Allahu e ka konsideruar të kotë dhe në këtë përkufizimin përfshihen të gjitha ato pasuri që burojnë nga harami, siç është kamata, vjedhja, rrëmbimi, rebelimi etj. Një kërcënim i fortë në Kuranin Famëlartë bëhet edhe për ngrënie e pasurisë së jetimit padrejtësisht apo dhe për vepra të tjera të ngjashme me të. Para me një fjalë, në pasurinë e kotë përfshihet cdo pasuri që vjen nga ngrënie e pasurisë së njerëzve padrejtësisht dhe nga tejkalimi i kufijve që ka vendosur Allahu në veprimet pasurore.

Etapat e pastrimit të parave

Pastrimi i parave të pista kalon në disa etapa, ku së pari është vendosja e tyre në një numër llogarie në të cilën vendosen shuma parash në formën e llogarive nëpër banka, në institucione financiare ose blerja e aksioneve në pasuri të patundshme. Ky veprim kryhet në kohë të ndryshme dhe nga persona të ndry-

shëm. Etapa e dytë është ajo e mashtrimit dhe e krijimit të tymnajës, ku krijohen disa veprime të ndërlikuara financiare me qëllim humbjen e gjurmëve dhe pamundësinë e ndjekjes së burimit të parave. Etapa e tretë është ajo e përzjerjes, në të cilën kryhet rikthimi i parave të pista në treg nëpërmjet kanaleve ekonomike apo transfertave të mbuluara nga investime dhe projekte financiare, që i japin pamjen normale dhe të pastër këtyre parave.

Pastrimi i pasurisë në sipas legjislacionit islam

Pasi njohëm disa nga burimet e pasurisë së ndaluar, le të njohim shkurtimisht mënyrat dhe format e pastrimit të pasurisë në Islam:

Pasuritë e fituara hallall dhe në mënyrë të lejuar pastrohen duke nxjerrë ato të drejta pasurore të detyrueshme, masën e të cilave e ka përcaktuar Islami, ashtu siç i ka bërë të detyrueshme Allahu a.xh. dhe siç i ka sqaruar i Dërguari i Tij, profeti Muhamed a.s.

- Nxjerrja e zekatit sipas llojit të pasurisë, nisabit (kufiri minimal i masës për zekat) dhe përqindjes së detyrueshme që duhet nxjerrë.
- Zekati i Fitrit.
- Detyrime të tjera pasurore që i detyron i pari vendit mbi të pasurit përveç zekatit.
- Shpagimet e detyrueshme, siç janë ato të betimit, vrasjes gabimisht apo me dashje, prishjes së agjërit në Ramazan etj.
- Zotimet që muslimani ia ngarkon vetvetes.
- Sadekaja, vakëfet, dhurata, amanetet pas vdekjes, të drejtat e fqinjësisë dhe të mikut etj.

g- Shpenzimet e detyrueshme, siç janë shpenzimet për familjen, prindërit, pagat e punëtorëve etj.

Qëndrimi i Islamit ndaj larjes së parave të pista dhe mënyra e shpagimit të tyre

Pak më lart bëmë të qartë faktin, se Islami e ndalon dhe e penalizon cdo përpjekje apo proces, që kryhet për pastrimin e parave, duke u përpjekur që këto pasuri haram të "pastrohen" përmes disa veprimeve bankare apo investimeve me qëllimin e vetëm për t'iu shmangur legjislacionit në fuqi dhe për të fshehur burimet e tyre të vërteta para syve të njerëzve. Përveç faktit që Islami e ndalon gënjeshtrën, mashtrimin dhe falsifikimin, pastrimi i parave e çon më tej këtë krim, duke i shtuar edhe krime të tjera. Ky lloj "pastrimi" nuk bën gjë tjetër veçse i bën këto para edhe më të pista seç ishin. Për këtë arsye pjesa më e madhe e legjislacioneve vendore dhe ndërkombëtare përkohë me legjislacionin islam përsa i përket penalizimit dhe konsiderimit të kësaj veprë si një krim. Bazuar mbi këtë të vërtetë, nuk lejohet që muslimani të jetë pjesë e këtij krimi dhe as të bashkëpunojë me të. Përsa i përket pastrimit legjitim të parave të pista, ky proces mund të realizohet në disa forma, ndër to mund të përmendim kthimin e pasurisë së marrë në mënyrë të ndaluar tek i zoti, nëse njihet ose duke i korigjuar marrëveshjet e parregullta. Nëse prejardhja e tyre vjen nga rrëmbimi apo mashtrimi, atëherë ato pasuri duhet t'i kthehen të zotit, e nëse shitja është e parregullt, atëherë marrëveshja e shitblerjes duhet të korigjohet, e nëse vjen nga kamata, atëherë pasuria duhet pastruar duke ia

nxjerrë shtesën e kamatës për të varfërit apo në shërbime publike për muslimanet, e nëse vjen nga mashtrimi dhe vjedhja, atëherë le t'ia kthejë të zotit, e nëse nuk mundet, le të pendohet dhe t'i japë fjalën Allahut se nuk do të kthehet përsëri.

Efektet negative të pastrimit të parave mbi shoqërinë

- Përhapja e kriminalitetit përmes veprimtarive kriminale, siç është droga, korrupsioni ekonomik dhe politik.
- Deformimi i aktivitetit ekonomik përsa i përket fitimit dhe konkurrencës, si dhe rrënimin të sipërmarrjeve të ndershme.
- Përhapja e organizatave kriminale dhe përfshirja e tyre në aktivitetet ekonomike dhe jetike të vendit.
- Shkaktimi i dëmeve të pallogaritshme për sistemin bankar përmes depozitimit dhe tërheqjes së parave, në mënyrë të papritur dhe të shpejtë.
- Nxjerrja e biznesmenëve dhe tregtarëve të ndershëm nga tregu përmes shkatërrimit të biznesit të tyre dhe falimentimit nga konkurrenca e pandershme.
- Cenimi i imazhit të institucioneve shtetërore duke inkurajuar krijimin e institucioneve dhe sipërmarrjeve kukulla pas të cilave fshihen aktivitetet jolegjitime.
- Ngritja e njerëzve me të ardhura jo të ligjshme në majën e piramidës sociale dhe ulja e pozitës sociale të sipërmarrësve të ndershëm, duke krijuar një anomali në vlerën e punës, studimit dhe fitimit të përvojës dhe krijimi i shembujve negativë në fitimin e pasurisë.

Familja qeliza bazë e shoqërisë

Nga Xhemal Balla

Familja është baza e shtimit të llojit njerëzor, me të cilën fillon e mbaron jeta individuale e secilit. Në familje çdo individ duhet të gjejë qetësi e ngrohtësi, sepse ajo është ngritur mbi bazën e dashurisë të sinqertë dhe mirëkuptimit reciprok që siguron jetesë të lumtur. Sipas islamit familja qëndron mbi bazën e lidhjeve të forta të partnerëve bashkëshortorë për të rritur dhe edukuar fëmijë me moral të pastër e të orientuar drejt në jetë. Megjithatë, sot në sajë të lirisë dhe të drejtave të njeriut, jeta e tyre po ndryshon dhe po priret gjithmonë drejt jetës së lirë private, duke u shkëputur nga edukata familjare dhe pastërtia e saj morale. Në sajë të kësaj lirie edhe bashkëshortët, burrë e grua, po priren për të bërë jetë të pavarur, duke u dhënë pas pasioneve të shfrenuara gjë që ka çuar e po çon gjithnjë e më shumë drejt shkatërrimit të familjes. Tradhëtia bashkëshortore është kryesisht viktimë e realitetit social, që po shkel mbi traditën, fenë, moralin, mbi parimet e dashurisë dhe të drejtave dhe detyrave reciproke. Ky fenomen ka sjell shtimin e shkurorëzimeve jo vetëm nga çiftet e rinj, por edhe nga radhët e atyre të moshës mesatare, fëmijët e të cilëve janë në moshë delikate.

Natyrisht ky është një fenomen serioz për shoqërinë, sepse pasojat janë shumë të rënda për fëmijët që mbeten jetimë. Kthimi i vetëdijes islame në familje krijon premisa të shëndosha për rritjen e përgjegjësisë që prindërit kanë ndaj fëmijëve, por njëkohësisht edukon edhe fëmijët me frymën e dashurisë dhe respektit ndaj prindërve, sidomos kjo kur prindërit kanë arritur moshën e pleqërisë. Gruaja po privohet shumë herë nga roli i saj për të cilin është krijuar, për përkujdesjen dhe rritjen e fëmijëve, duke ia lënë ata kujdestarëve që marrin për shërbime në shtëpi. Madje ka nga ato gra që më shumë janë dhënë pas mbajtjes së qenëve dhe kujdesit ndaj tyre, duke i nxjerrë edhe në shëtitje, duke mos llogaritur rrezikun që mbartin ata për shëndetin e njeriut.

Mjeku psikiatër, Dr. Xhorxh Meli thotë: "Shumë pengesa psikologjike tek të rinjtë janë shkaktuar nga kujtimet e fëmijërisë së hershme, për të cilat fajin e mbartin nënat e tyre. Gënjeshtër... dhe mosrespektimi i rregullave paraqiten tek të rinjtë, të cilët nuk e kanë patur përkujdesjen e nënës".

Në realitetin e sotëm shumë nëna po i braktisin fëmijët, sepse i kanë me lidhje jashtëmartesore dhe asnjëri nuk merr përsipër rritjen dhe kujdesin ndaj tyre. Ata rriten në shtëpitë e fëmijëve jetimë, por mbeten jashtë edukatës familjare dhe pa një shtëpi që të ndërtojnë jetën e tyre. Dashuria për nënën është kaq e madhe sa i bën shumë prej tyre që në moshë madhore të vihen në kërkim të nënës edhe se mund të jenë vetë me fëmijë. Mjaft prekëse e të dhimbshme kanë qenë rastet e trajtuara në emisionin televiziv "Njerëz të humbur". Për shkak të mungesës së kujdesit të prindërve, shumë fëmijë i janë nënshtruar vetmisë, që shpeshherë



vjen me pasoja. Tek fëmijë të tillë mungon dashuria dhe miqësia reciproke në mes antarëve të shoqërisë, sepse u ka humbur ajo lidhje shpirtërore që i jep gjallëri jetës së tyre. Vetëm kthimi i vlerave shpirtërore në familjet tona, nëpërmjet kthimit të besimit tek Zoti, do të bëjë të mundur shmangien nga këto fenomene negative që po lulëzojnë në shoqërinë tonë.

Familja është një institucion Hyjnor, origjina e së cilës të çon deri në krijimin e çiftit të parë njerëzor, që shumoi shoqërinë njerëzore. Si e tillë ajo mbetet bazë për shtimin e llojit njerëzor. Në Kuran thuhet: "O ju njerëz, kujtohuni për detyrën që kini ndaj Zotit tuaj, i cili ju krijoi nga një çift i vetëm..." dhe në një vend tjetër thuhet: "Krijimi i mashkullit dhe i femrës dhe raporti i tyre martesor, i përshkruar nga siguria, dashuria dhe mirëkuptimi reciprok janë përshkruar si shënja të Zotit". Institucioni i familjes dhe ai i martesës janë përshkruar si praktika të profetëve. Muhammedi, paqja e bekimi i Zotit qoftë mbi të, thotë: "Martesa është pjesë e praktikës sime jetësore dhe kushdo që i largohet praktikës sime jetësore, nuk është nga ne".

Institucioni i familjes luan një rol mjaft të rëndësishëm në shoqëri. Familja është njësi themelore e kësaj shoqërie. Ajo organizohet në mënyrë të tillë që mund të sillet si një shoqëri e vogël. Rreth një e treta e normave juridike që përfshihen në Kuran i referohen familjes dhe përcaktojnë rregullat e funksionimit të saj. Pozita e barabartë e sekseve është përcaktuar nga vetë Zoti i madhërishtëm, i cili krijoi si mashkullin edhe femrën, të barabartë për shtimin e llojit njerëzor, por të barabartë dhe në jetën e përditshme, në familje e në shoqëri. Në Kuran thuhet: "Bashkëshortë, ju jini për njëri tjetrin si një veshje". Këtu theksohet qartë se në mes të bashkëshortëve duhet të ekzistojë një lidhje e fortë, në unitet, që përbën trajtimin e barabartë në mes tyre. Kurani ka përcaktuar bukur se "burri e gruaja janë si veshje e njëri tjetrit". Dihet që veshja e zbukuron atë që e vesh dhe të dy zbukurojnë njëri tjetrin.

Roli i familjes mbetet i paplotësuar, në se nuk realizon rritjen e fëmijëve të vet, me edukatë të shëndoshë, me arsim e kulturë duke përfshirë edhe kulturën islame. Prindërit duhet të synojnë rri-

tjen dhe formimin e personalitetit të tyre të shëndoshë, si nga ana fizike edhe nga ana mendore e shpirtërore, për ta bërë atë të aftë si qytetar, por dhe për mbrojtjen e vendit të tij. Nga ana tjetër edhe fëmijët kanë detyrime ndaj prindërve të tyre. Në Kuran thuhet: "Silluni mirë ndaj prindërve, ndaj të afërmeve, ndaj jetimëve, të varfërve, ndaj fqinjëve". Një sjellje e tillë ka pasoja pozitive jo vetëm brënda familjes, por përçohet edhe në shoqëri. Sipas islamit, respekti i fëmijëve ndaj prindërve duhet të vazhdojë edhe pas ndërrimit jetë të tyre, duke u lutur për ta, që shpirti i tyre të gjejë qetësi pranë Zotit të madhërishtëm. Që të realizojmë një detyrë të tillë ndaj fëmijëve, përsëri bazë mbetet familja. Profeti Muhammed, paqja e bekimi i Zotit qofshin mbi të, thotë: "Ju që të gjithë jeni kujdestarë dhe që të gjithë do të përgjigjeni për atë që u është dhënë në ruajtje (përkujdesje, Buhari)".

Tek fëmijët nuk ka ndikim vetëm familjar, por edhe faktorë të tjerë të mjedisit social e kryesisht mediat, që mund të sjellin shumë pasoja negative në se nuk kontrollohen mirë emisionet e tyre. Po kështu në mjediset shoqërore, në rrugë e kudo ndeshemi me fenomene të ndryshëm si sharje, fyerje, fjalor banal, mungesë respekti ndaj më të moshuarve e sjellje të tjera të papëlqyeshme. Për të përballuar me sukses këtë ndikim negativ, familja ka rolin dominues nëpërmjet ndërhyrjeve aktive për të bërë sqarimet e nevojshme mbi dallimin e së mirës nga e keqja dhe për të mos i lënë të bëhen viktimë e këtyre ndikimeve të këqia. Si prindërit edhe fëmijët kanë të drejtat e liritë e tyre, por këto liri e këto të drejta, kanë edhe detyrime. Ajo duhet kontrolluar e drejtuar jo vetëm në shtëpi, por edhe jashtë saj.

Të edukosh një fëmijë të shëndetshëm fizikisht, mendërisht e shpirtërisht është detyrë e shenjtë. Megjithatë jemi dëshmitarë të rasteve mospërfillëse të fëmijëve ndaj prindërve, nuk i respektojnë, i ofendojnë, nuk i ndihmojnë, madje edhe raste ekstreme të përdorimit të dhunës ndaj tyre. Zoti në Kuran thotë: "Ne e urdhëruam njeriun t'u bëjë mirë prindërve të vet, meqenëse nëna e vet e mbart me vështirësi dhe me vështirësi e lind". Pra, nëna, fëmijën e vet e ka mbartur nëntë muaj si pjesë e

pandarë e trupit të saj dhe e ka ushqyer me të njëjtin ushqim. Pastaj e lind dhe e rrit me vështirësi duke sakrifikuar çdo gjë për të. Ndjenjat e saj janë shumë të ndjeshme dhe të ngrohta për fëmijën, sado i madh që të jetë. Këtë e vërteton edhe një hadithe e profetit a.s. që e transmeton Ebu Hyrejreja i cili thotë:

"Erdhi një njeri tek pejgamberi i Zotit dhe e pyeti :

-Kush ka më shumë meritë që t'i kushtohet kujdes i plotë?

-Nëna - tha profeti a.s.

-Po pastaj kush vjen pas radhës?

-Përsëri Nëna - tha Profeti a.s.

-Pastaj kush vjen ?

-Përsëri Nëna dhe pastaj vjen babai - tha i dërguari i Zotit" (Buhari-Muslim)

Familja duhet të ruhet e shëndoshë dhe të mos preket shenjtëria e saj, veçanërisht e nënës. Për fat të keq kjo po dhunohet më shumë sot, në kushtet e reja të përparimit e zhvillimit demokratik të shoqërisë. Për këtë i duhet kthyer vetëdijes islame dhe mësimet e islamit, i cili i luftoi që në themel të gjitha të këqiat dhe nënçmimet ndaj personalitetit të femrës.

Në Kuran ka një kapitull të veçantë që emërtohet "En-Nisa" dhe që flet kryesisht për femrën, mbi rolin e saj në trashëgimi, mbi lirinë e saj për të krijuar familje dhe detyrat e saj si bashkëshorte, si nënë dhe si pjestare e shoqërisë. Islami i ka dhënë femrës vendin e merituar në shoqëri. Në këtë kuadër parashikohen edhe masa ndëshkimore në qoftë se ajo shkel ligjet dhe normat e përcaktuara për të.

Martesa e ligjshme bazohet në normat islame dhe ka për qëllim ruajtjen e individit, familjes dhe shoqërisë nga prishja e moralit. Nëpërmjet martesës së ligjshme, sipas dispozitave të jurisprudencës islame, bashkëshortët ndihmohen për formimin e familjes, e cila mbart mbi vete të ardhmen e shoqërisë. Martesa e shpëton shoqërinë nga sëmundjet e shumta, të cilat vijnë kryesisht si pasojë e mospërfilljes së normave të moralit islam dhe tradhëtisë bashkëshortore e në veçanti prostitucioni, i cili ka sjellë pasoja të rrezikshme në shoqërinë e sotme me sëmundjen vdekjeprurëse të SIDA-s, që për fat të keq ka hyrë edhe në vendin tonë. Për këtë në një familje të shëndoshë i duhet prerë rruga këtij fenomeni, sepse vetëm në familje partnerët gjejnë kënaqësi, rehati e lumturi së bashku me fëmijët e tyre të cilët ua shtojnë dashurinë, shpresën dhe angazhimin për t'i edukuar e frymëzuar në rrugën e drejtë deri sa të bëhen zotër të vetes dhe të njohin të drejtat e përgjegjësitë në këtë botë provizore.

Edukata dhe morali në familje janë faktorët më të rëndësishëm, nëpërmjet të cilëve kultivohet miqësia dhe qetësia shpirtërore, sidomos në mes burrit dhe gruas. Profeti a.s.thotë: "Më i miri prej jush është më i sjellshmi në familjen e tij..." (Tirmidhiu). Në një hadith tjetër thuhet: "Vërtet besimin më të plotë e ka ai besimtar që ka moralin më të lartë dhe sillet mirë me familjen e tij" (Tirmidhiu).



A.M.B.C

ALBANIAN MUSLIM BUSINESS CENTRE



www.lidhjatregtareve.com



DYQANI I MISHIT "HALLALL"

- ✓ Tregton mish vici, qengji, qofte dhe sallameri të firmës "Meka", me shumicë dhe pakicë.
- ✓ Ofron qengja për kurbanë dhe akika.

Adresa: Rr. "Bedri Cullhaj", tek Goni, pranë Xhamisë së Kombinatit
 Tel: 04 2350569; Cel: 0672050070
 Email: agronxhepa@hotmail.com

DYQANI I MISHIT "HALLALL", Kombinat